




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-3234/12</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>13-09-2012</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.08.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-5085/11, për Zyrtarin e Lartë, z. Shefqet Lulaj, Drejtor i Klinikës Gjinekologjike dhe Obstetrike ne Qendrën Klinike Universitare te Kosovës, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-5089/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, Shefqet Lulaj, Drejtor i Klinikës Gjinekologjike dhe Obstetrike ne Qendrën Klinike Universitare te Kosovës.

Pas informatës se marre gjate kontrollit te formularit për deklarim te pasurisë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK–03-5085/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z. Shefqet Lulaj, Drejtor i Klinikës Gjinekologjike dhe Obstetrike ne Qendrën Klinike Universitare te Kosovës.

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si Drejtor i Klinikës Gjinekologjike dhe Obstetrike ne Qendrën Klinike Universitare te Kosovës, ka qene i regjistruar ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve ARBK, si person i autorizuar dhe pronarë ne biznesin “N.SH.Aulona” e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 29.02.2012, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme

të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z.Shefqet Lulaj, Drejtor i Klinikës Gjinekologjike dhe Obstetrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ka dërguar një shkresë informuese dhe ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ku ka kërkuar të ballafaqohet me faktet që posedon Agjencia.

Me datën 27.03. zyrtarët e Agjencisë kanë qenë në takim me z.Shefqet Lulaj, ku e kanë njoftuar për situatën dhe për provat që disponojnë, si dhe është biseduar për gjendjen e mundshëm të konfliktit të interesit të paraparë sipas ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i Lartë, z.Shefqet Lulaj, gjatë takimit është pajtuar për situatën mirëpo është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar askush se kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit. Dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, dhe është arsyetuar se është zgjedhur si ushtrues i detyrës së drejtorit të Klinikës, për shkak të mungesës së stafit dhe pritet që shumë shpejtë të shpallet konkursi për drejtor, ku dhe do të përcaktoj se cilën pozitë do ta mbajë, dhe do të eliminoj çfarëdo situatë të konfliktit të interesit.

z. Shefqet Lulaj, është zotuar se në afatin ligjor do të bëjë ndryshimet në këtë biznes, ose do të largohet nga funksioni menaxhues si Drejtor i Klinikës, për ta shmangur çfarëdo gjendje që mund të shkaktoj konflikt të mundshëm të interesit.

Me datën 08.07.2012, Zyrtari i lartë, z.Shefqet Lulaj, Drejtor i Klinikës Gjinekologjike dhe Obstetrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ka sjellë dëshmitë e lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë se nuk ka me pozitën e drejtorit të Klinikës Gjinekologjike dhe Obstetrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve konstatojmë se :

Zyrtari i lartë z.Shefqet Lulaj, Drejtor i Klinikës Gjinekologjike dhe Obstetrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej pasi që nuk ushtron më pozitën e Drejtorit në Klinikën Gjinekologjike dhe Obstetrike. Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si Drejtor i Klinikës Gjinekologjike dhe Obstetrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe pozitës si person i autorizuar dhe pronar në biznesin privat "N.SH.Aulona".

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

